




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dap	DPK
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	03-02/4214/18
Data Datum Date	29.11.2018
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.11.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2759/18, për zyrtarin e lartë z. Ergin Kala, Anëtar i Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Ergin Kala, Anëtar i Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht Drejtor në Shoqatën “Kosova Turkleri Milli Bayrami Vakfi” dhe në Shoqatën “Hana e Gjelbert”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë z. Ergin Kala, është bindur për kufizimin e përcaktuar në Ligjin nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni 14 (paragrafi 1), në të cilën thuhet:

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar nga zyrtari i lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksionit drejtues në Shoqatat e cekura më lartë.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare (03-02-4160/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Ergin Kala, ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit drejtues - Drejtor në Shoqatën "Kosova Turkleri Milli Bayrami Vakfi" dhe në Shoqatën "Hana e Gjelbert".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

